



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 7254 prot.

Tiranë, më 28.12.2023

URDHËR

Nr. 723, datë 28.12.2023

PËR

MIRATIMIN E STRATEGJISË SË KOMUNIKIMIT NË FUSHËN E
DREJTËSISË TË MINISTRISË SË DREJTËSISË



Në mbështetje të nenit 7, pika 2 e ligjit nr.8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Strategjisë së Komunikimit në Fushën e Drejtësisë të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategjive në Fushën e Drejtësisë, në cilësinë e drejtorisë përgjegjëse për monitorimin dhe hartimin e politikave në fushën e drejtësisë për monitorimin e kësaj strategjie, si dhe njoftimin e drejtorive të përfshira në këtë strategji.
3. Ngarkohen të gjitha drejtoritë të përmendura në këtë strategji, për zbatimin e këtij urdhri.
4. Publikimi i Strategjisë së Komunikimit në Fushën e Drejtësisë në faqen web të Ministrisë së Drejtësisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR
ULSI MANJA



JUSTAL

Asistencë Teknike për Mbështetjen e Zbatimit të Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë në Shqipëri

Strategjia e Komunikimit
në Fushën e Drejtësisë
e
Ministritë së Drejtësisë
së Republikës së Shqipërisë

Dokument


v.4

Tiranë, Dhjetor 2023

Ky dokument u përgatit me mbështetjen e JUSTAL, një projekt asistence teknike i financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Ministritë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

JUSTAL

Asistencë Teknike për Mbështetjen e Zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë në Shqipëri

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1. HISTORIKU.....	5
1.1. Analiza e situatës.....	6
1.2. Lidhja me dokumente të tjera strategjike.....	5
2. MISIONI DHE VIZIONI PËR KOMUNIKIM DHE VLERAT THEMELORE.....	6
2.1. Misioni ynë për komunikimin	6
2.2. Vizioni ynë për komunikimin	6
2.3. Vlerat tona themelore për komunikim.....	6
3. OBJEKTIVAT E KOMUNIKIMITË MD-SË.....	6
4. AUDIENCAT E SYNUARA	8
5. KANALET DHE MJETET E KOMUNIKIMIT.....	8
6. NARRATIVA (PËRSHKRIME) DHE MESAZHE.....	9
7. PËRGJEGJËSITË, MONITORIMI DHE VLERËSIMI.....	9
8. SUPOZIMET DHE RISQET.....	10
9. BURIMET FINANCIARE	11

JUSTAL

Asistencë Teknike për Mbështetjen e Zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë në Shqipëri

Përmbledhje ekzekutive

Ministria e Drejtësisë (MD) ka përgatitur një Strategji dhe Plan Komunikimi gjithëpërfshirës për të përcjellë misionin dhe vizionin e saj tek publiku. Strategjia fokusohet në pesë vlera thelbësore, të cilat përfshijnë: transparencën, llogaridhënien, aksesueshmërinë, profesionalizmin dhe bashkëpunimin. Këto vlera do t'i shërbejnë qëllimit për të ofruar akses të lehtë në informacione dhe shërbime dhe për të nxitur një komunitet më të lidhur dhe më të angazhuar.

Strategjia e komunikimit përshkruan pesë objektiva të përgjithshëm dhe dhjetë objektiva specifike. Komunikimi efikas është thelbësor për të siguruar që politikat dhe strategjitë e drejtësisë, si dhe ligjet, të zhvillohen në një mënyrë të integruar dhe me pjesëmarrjen e duhur, në mënyrë që individët të kenë akses në burimet dhe informacionet që u nevojiten për të marrë pjesë plotësisht në hartimin e politikave, si dhe të kuptojnë dhe të mbështesin proceset dhe zhvillimet e reformës në Sektorin e Shtetit të Drejtësisë.

MD-ja e di mirë rëndësinë e komunikimit efikas për të garantuar transparencë dhe besim publik në sistemin e drejtësisë. Kjo Strategji Komunikimi synon të sigurojë një kuadër për komunikim të qëndrueshëm dhe të synuar që angazhon palët kryesore të interesuara dhe promovon të kuptuarit e misionit dhe veprimtarive të Ministrisë.

Strategjia përshkruan parimet kryesore të komunikimit efikas, siç janë mesazhet e përqendruara te audienca dhe përdorimi i kanaleve të përshtatshme për grupe të ndryshme të synuara. Ajo identifikon gjithashtu qëllimet kryesore të komunikimit, duke përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit për sistemin e drejtësisë dhe funksionimin e tij, promovimin e aksesit në drejtësi dhe rritjen e besimit të publikut në veprimtaritë e Ministrisë.

Për të arritur këto qëllime, strategjia propozon pesë objektiva të përgjithshëm, të cilët përfshijnë:

- (1) fuqizimin e komunikimit mbi politikat dhe strategjitë e drejtësisë;
- (2) zhvillimin e legjislacionit në lidhje me drejtësinë;
- (3) progresin e negociatave në kapitullin 23 për anëtarësimin në BE; ndërkohë që
- (4) promovohet aksesit në drejtësi duke shpërndarë informacione të qarta dhe të sakta mbi kuadrin ligjor dhe mjetet në dispozicion; si dhe
- (5) promovohet ligjshmëria në shërbimet e profesioneve të lira ligjore.

Këta pesë objektiva parashikohen të arrihen nëpërmjet objektivave specifike, duke përfshirë përgatitjen e fushatave ndërgjegjësuese për kategori të caktuara veprimtarish të MD-së, zhvillimin e veprimtarive

JUSTAL

Asistencë Teknike për Mbështetjen e Zbatimit të Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë në Shqipëri konsultative, zhvillimin e materialeve të komunikimit ose dhënien e përditësimeve të rregullta mbi zhvillimet.

JUSTAL

Asistencë Teknike për Mbështetjen e Zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë në Shqipëri

1. Historiku

MD-ja luan një rol jetik në zhvillimin dhe zbatimin e politikave, strategjive dhe ligjeve të drejtësisë, të cilat janë të përafuara hap pas hapi me *acquis*-në e BE-së dhe si koordinatore e politikave të drejtësisë dhe monitorimit të zbatimit të tyre, si dhe është angazhuar për të siguruar se drejtësia u ofrohet të gjithë qytetarëve. Për të komunikuar në mënyrë efikase misionin dhe vizionin e saj, MD-ja ka hartuar një Strategji Komunikimi gjithëpërfshirëse, e cila fokusohet në pesë vlera thelbësore. Këto vlera përfshijnë: transparencën, llogaridhënien, aksesueshmërinë, profesionalizmin dhe bashkëpunimin. Duke iu përmbajtur këtyre vlerave thelbësore, komunikimi i MD-së synon të nxisë ndërtimin e besimit dhe besueshmërisë nga publiku, të sigurojë akses të lehtë në informacione dhe shërbime dhe të nxisë një komunitet më të lidhur dhe më të angazhuar.

Në përputhje me politikat e përgjithshme shtetërore dhe programin e Qeverisë, MD-ja ka 30 funksione, duke përfshirë përgjegjësinë e saj për zhvillimin dhe ndjekjen e politikave, strategjive dhe akteve ligjore të drejtësisë. MD-ja kryen gjithashtu një gamë të gjerë shërbimesh në lidhje me sistemin e drejtësisë, duke përfshirë sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale dhe civile, mbikëqyrjen e shërbimeve të profesioneve të lira ligjore, bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet civile dhe penale dhe të tjera. MD-ja mbështet, bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet e saj me institucionet e pavarura gjyqësore dhe ato të prokurorisë duke respektuar parimin e ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë. Përtej sistemit të drejtësisë, MD-ja siguron bashkërendimin dhe harmonizimin e legjislacionit shqiptar në tërësi.

Në kryerjen e funksioneve të saj, MD-ja synon të sigurojë respektimin e Kushtetutës, ligjeve, të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe kontribuon në parandalimin e shkeljeve të ligjit në përputhje me parimin demokratik dhe kërkesat e integritetit evropian.

Në vitin 2021 u themelua Agjencia për Media dhe Informim (MIA) në varësi të Kryeministrit, me misionin për të garantuar transparencë, në raport me politikat, aktivitetet, projektet, eventet. Pas themelimit, të gjithë zyrtarët për marrëdhënie me mediat në ministrinë dhe institucionet e administratës shtetërore janë transferuar tek MIA.

1.1. Lidhja me dokumente të tjera strategjike

Strategjia e Komunikimit të MD-së është e lidhur ngushtë me plane dhe dokumente të tjera strategjike për organizimin e duhur. Kjo përfshin misionin dhe vizionin e përgjithshëm të MD-së, si dhe synimet dhe objektivat specifike të përshkruara në plane të tjera strategjike si:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2021-2030 (SKZHI)
- Plani Kombëtar për Integrimin Evropian (PKIE)
- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025

JUSTAL

Asistencë Teknike për Mbështetjen e Zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë në Shqipëri

- Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Miturit 2022-2026
- Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2020-2023
- Strategjia e Edukimit Ligjor për Publikun 2019-2023

2. Misioni dhe Vizioni për Komunikim dhe Vlerat Themelore

2.1. Misioni ynë për komunikimin

Rritja e ndërgjegjësimit dhe ofrimi i informacionit për publikun në lidhje me politikën, strategjitë dhe kuadrin ligjor të drejtësisë që garanton shtetin e së drejtës, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, sigurimin e aksesit të barabartë në drejtësi dhe luftën efikase kundër korrupsionit.

MD-ja zhvillon dhe zbaton politika dhe ligje që synojnë të sigurojnë ofrim transparent, të shpejtë dhe efikas të shërbimeve të lidhura me drejtësinë për çdo person, duke garantuar lehtësinë e kryerjes së punëve dhe rritjen e shkallës së besimit të publikut në shtetin e së drejtës.

2.2. Vizioni ynë për komunikimin

Rritja e ndërgjegjësimit për proceset dhe zhvillimet drejt një sistemi drejtësie efikas dhe të koordinuar, pa korrupsion, të përgjegjshëm ndaj të gjithë qytetarëve dhe në përputhje të plotë me standardet dhe praktikën më të mira të BE-së, garanton shtetin e së drejtës dhe përmirëson klimën e biznesit në Shqipëri.

2.3. Vlerat tona themelore për komunikim

Ministria e Drejtësisë angazhohet për këto vlera themelore për komunikim:

Transparencë dhe llogaridhënie: MD-ja vlerëson transparencën dhe ndershmërinë në komunikim dhe përpiqet të sigurojë informacione të sakta dhe të besueshme për palët e interesuara.

Përgjegjshmëria: MD-ja është e përkushtuar që të adresojë shqetësimet dhe pyetjet e palëve të interesuara në kohën e duhur dhe me respekt.

Aksesueshmëria: MD-ja beson në realizimin e aksesueshmërisë së informacionit për të gjitha palët e interesuara dhe do të përpiqet të ofrojë informacione në një sërë formatesh dhe gjuhësh.

Bashkëpunimi: MD-ja e njeh mirë rëndësinë e bashkëpunimit me agjencitë e tjera qeveritare, palët e interesuara dhe publikun për të arritur misionin e saj.

3. Objektivat e komunikimit të MD-së

MD-ja është përgjegjëse për të siguruar që përpjekjet e komunikimit të përputhen me qëllimet e përgjithshme të programit të qeverisë, standardet ndërkombëtare dhe praktikën më të mira. Komunikimi

JUSTAL

Asistencë Teknike për Mbështetjen e Zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë në Shqipëri

i MD-së udhëhiqet nga pesë objektiva të përgjithshëm dhe dhjetë objektiva specifike, siç vijojnë më poshtë, të cilat do të arrihen nëpërmjet veprimtarive të MD-së në fushën e komunikimit.

Objektivi i përgjithshëm 1:

Fuqizimi i komunikimit mbi politikat dhe strategjitë e drejtësisë dhe zbatimin e tyre, duke përfshirë çështjet e anëtarësimit në BE.

Objektivat specifikë

1. Sigurimi i hartimit të fushatave ndërgjegjësuere në lidhje me zhvillimin e çdo strategjie, gjatë fazës së hartimit të raportit të vlerësimit të *status quo*-së dhe zbatimit të fushatës.
2. Sigurimi i veprimtarive të rregullta të komunikimit në veçanti sa herë që përpunohet një raport monitorimi për të lehtësuar angazhimin dhe konsultimin efikas të palëve të interesuara.
3. Drejtimi i eventeve konsultative me grupe të ndryshme të synuara për të mbledhur komente dhe të dhëna për të siguruar që përpjekjet e Ministrisë në fushën e komunikimit përshtaten në mënyrë të tillë që të përmbushin nevojat dhe pritshmëritë e palëve kryesore të interesuara.

Objektivi i përgjithshëm 2:

Fuqizimi i komunikimit për zhvillimin e legjislacionit të lidhur me drejtësinë, duke përfshirë çështjet e anëtarësimit në BE.

Objektivat specifikë:

1. Hartimi dhe zbatimi i fushatave ndërgjegjësuere gjatë fazës së zhvillimit të planit vjetor legjislativ për të nxitur një angazhim më të madh publik dhe për të siguruar komunikim efikas në lidhje me ndryshimet kryesore të politikave dhe ndryshimet legjislative.
2. Drejtimi i eventeve konsultative me grupe të ndryshme të synuara për të mbledhur komente dhe të dhëna përpara marrjes së vendimeve për politikat dhe në kontekstin e hartimit të propozimeve legjislative.

Objektivi i përgjithshëm 3:

Fuqizimi i komunikimit për progresin në negociata në Kapitullin 23

Objektivat specifikë:

1. Hartimi, zhvillimi dhe shpërndarja e fushatave të synuara ndërgjegjësuere që i drejtohen publikut vendas për të përmirësuar perceptimin e tyre në lidhje me procesin e anëtarësimit në BE dhe të drejtat dhe përgjegjësitë që dalin nga anëtarësimi, në veçanti Kapitulli 23.
2. Rritja e ndërgjegjësimit midis grupeve të ndryshme të synuara, duke përfshirë organizatat dhe institucionet publike dhe private, për të ngritur nivelin e njohurive profesionale dhe për të lehtësuar angazhimin dhe pjesëmarrjen në procesin e anëtarësimit në BE.

JUSTAL

Asistencë Teknike për Mbështetjen e Zbatimit të Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë në Shqipëri

Objektivi i përgjithshëm 4:

Forcimi i komunikimit mbi mjetet në dispozicion për të siguruar akses në drejtësi

Objektivat specifikë:

1. Zhvillimi dhe shpërndarja e informacioneve të qarta dhe të sakta mbi kuadrin ligjor dhe mjetet e disponueshme për të promovuar aksesin në drejtësi për publikun e gjerë.
2. Drejtimi i eventeve konsultative dhe mbledhja e përshtypjeve nga grupe të ndryshme të synuara për të siguruar se përpjekjet në fushën e komunikimit përshtaten për të përmbushur nevojat dhe pritshmëritë e tyre specifike.

Objektivi i përgjithshëm 5:

Fuqizimi i komunikimit për promovimin e ligjshmërisë në profesionet e lira ligjore.

Objektivat specifikë

1. Zhvillimi dhe shpërndarja e informacionit mbi veprimtaritë e MD-së për të përmirësuar performancën e profesioneve të lira ligjore dhe tendencave në këtë sektor.

4. Audiencat e synuara

MD-ja e ka identifikuar publikun e gjerë si audiencën kryesore të synuar për përpjekjet e saj në fushën e komunikimit. Megjithatë, ajo njih mirë gjithashtu rëndësinë e adresimit të audiencave specifike të synuara që preken drejtpërdrejt nga politikat, strategjitë, ligjet dhe rregulloret, duke përfshirë në veçanti organizatat përkatëse të shoqërisë civile, autoritetet zbatuese, grupet profesionale, donatorët (ndërkombëtarë) dhe organizatat monitoruese aktive në fushën përkatëse.

Grupet specifike të synuara janë të përfshira në Planin e Komunikimit.

5. Kanalet dhe mjetet e komunikimit

MD-ja zgjedh me kujdes kanalet dhe mjetet e komunikimit për të arritur në mënyrë efektive audiencën e saj të synuar, duke marrë në konsideratë aftësitë dhe burimet e ndryshme të komunikimit që ka në dispozicion. Duke vepruar kështu, MD-ja i jep përparësi aksesueshmërisë, pranimi të faktit se jo të gjithë qytetarët kanë akses në mediat elektronike ose aftësitë për të kuptuar informacione komplekse.

Ja disa kanale dhe mjete komunikimi që, ndër të tjera, do të përdoren për të arritur objektivat specifikë :

- Faqja e internetit e MD-së
- Konsultime dhe takime publike
- Sondazhe (*online* dhe *offline*) dhe seksione të dedikuara në faqet zyrtare të internetit për komente publike
- Platforma të mediave sociale

JUSTAL

Asistencë Teknike për Mbështetjen e Zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë në Shqipëri

- Buletine që dërgohen me email
- Reklama në radio dhe television
- Broshura informuese

6. Narrativa (Përshkrime) dhe Mesazhe

MD-ja do të përcaktojë për çdo veprimtari komunikimi, siç përcaktohet në Planin e Komunikimit, narrativa (përshkrime) dhe mesazhe që janë elementë thelbësorë të një strategjie komunikimi, por ato shërbejnë për qëllime të ndryshme. Në narrativa, MD-ja do të përpunojë përshkrimin ose temën gjithëpërfshirëse që unifikon të gjitha mesazhet dhe veprimtaritë e komunikimit brenda një aktiviteti komunikimi me synimin për të përcaktuar konceptet, vlerat dhe qëllimet kryesore që strategjia synon të përcjellë dhe lehtëson krijimin e një mesazhi të qëndrueshëm në të gjitha kanalet e komunikimit. Me anë të mesazheve, MD-ja do të përcjellë informacione ose ide specifike që përshtaten për t'u përcuar tek grupe të ndryshme interesi, me synimin për të ofruar informacione koncize dhe të fokusuara për tema ose çështje të caktuara. MD-ja do t'i hartojë ato në një mënyrë lehtësisht të kuptueshme dhe që mbahen mend. Së bashku, një narrativë e hartuar mirë dhe mesazhet e synuara janë thelbësore për suksesin e një strategjie komunikimi, pasi ato funksionojnë në të njëjtën kohë për të krijuar një mesazh koheziv dhe me ndikim.

Narrativa dhe mesazhet specifike – aty ku është e përshtatshme – përfshihen në Planin e Komunikimit.

7. Përgjegjësitë, Monitorimi dhe Vlerësimi

Ministria e Drejtësisë ka krijuar një strukturë të mirëpërcaktuar përgjegjësisë për të koordinuar aktivitetet e komunikimit, duke përfshirë zhvillimin, përgatitjen, zbatimin dhe monitorimin e tyre për përmbushjen e planit të komunikimit dhe vlerësimin e rezultateve të tij.

Të gjitha aktivitetet e komunikimit janë të përcaktuara në Planin e Komunikimit, i cili do t'i nënshtrohet përditësimeve të rregullta në nëntor për vitin e ardhshëm. Gjatë çdo përditësimi, drejtoritë paraqesin rekomandime për aktivitetet brenda fushave të tyre të punës.

Kabineti ministror konsolidon planin e përditësuar të komunikimit për miratim përfundimtar në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga MD-ja.

Të gjitha aktivitetet e komunikimit duhet t'i përmbahen programit të përcaktuar në Planin e Komunikimit. Drejtoritë e MD-së janë përgjegjëse për hartimin e buletineve, përgatitjen dhe realizimin e eventeve, si tryeza të rrumbullakëta, takime të rregullta me Shoqërinë Civile, apo evente bashkëpunimi me organizata partnere, konceptualizimin dhe zbatimin e fushatave ndërgjegjësuese, konkurseve, seminareve për audiencat e synuara dhe përgatitjen dhe dizajnin e botimeve.

JUSTAL

Asistencë Teknike për Mbështetjen e Zbatimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë në Shqipëri

Kabineti koordinon të gjitha aktivitetet e komunikimit duke ndjekur rregullat dhe procedurat e përcaktuara nga MD-ja me një urdhër të veçantë.

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë së Komunikimit dhe Planit të Komunikimit do të realizohet nëpërmjet një sistemi monitorimi dhe vlerësimi që lidhet me përmbushjen e objektivave, masave ose aktiviteteve të planifikuara. Ky proces do të mundësojë rishikimin e objektivave, masave apo aktiviteteve dhe shpërndarjen e burimeve financiare.

Procesi i vlerësimit të aktiviteteve të realizuara do të zhvillohet sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara nga MD-ja me një urdhër të veçantë. MD-ja do të përdorë tregues vlerësimi më të avancuar të përshtatur me specifikat e kanaleve dhe mjeteve të komunikimit, të tilla si treguesit e performancës në evente, përshtypjet dhe komentet në mediat sociale, anketat në faqet e internetit dhe analizat e mediave të zakonshme si: televizioni dhe media e shkruar për të vlerësuar volumin dhe cilësinë e raporteve.

8. Supozimet dhe Risqet

Strategjia e Komunikimit e MD-së bazohet në supozimet e mëposhtme:

- Audiencia e synuar do të marrë dhe kuptojë mesazhin ashtu siç synohet.
- Mesazhi do të ketë ndikimin e dëshiruar dhe do të ndikojë në perceptimet ose sjelljen e audiencës.
- Kanalet e komunikimit të përdorura për të dhënë mesazhin do të jenë të përshtatshme për audiencën e synuar dhe qëllimet e strategjisë.
- Komunikimi i MD-së bazohet në një analizë të plotë të nevojave dhe pritshmërive të audiencës së synuar.
- Strategjia e Komunikimit përputhet me qëllimet dhe vlerat e përgjithshme të MD-së

MD-ja identifikoi risqet e mëposhtme që mund të dëmtojnë efikasitetin e veprimtarive të komunikimit:

- Mesazhet e MD-së mund të keqinterpretohen ose keqkuptohen nga audiencia e synuar. Masat zbutëse: Veprimtaritë e komunikimit do të përfshijnë mekanizmat e komenteve dhe mjetet e monitorimit për të vlerësuar komentet e audiencës.
- Kanalet e përzgjedhura të komunikimit mund të mos arrijnë audiencën e synuar në mënyrë efikase, duke çuar në angazhim ose përhapje në nivel të ulët. Masat zbutëse: Veprimtaritë në fushën e komunikimit do të përfshijnë kanale dhe metoda të shumta për të siguruar përhapje maksimale.
- Mesazhet mund të priten me reagime të ashpra ose reagime negative nga audiencia. Masat zbutëse: Veprimtaritë e komunikimit do të trajtojnë në mënyrë proaktive shqetësimet ose kundërshtimet dhe do të ofrojnë informacione transparente dhe mesazhe të qarta.

JUSTAL

Asistencë Teknike për Mbështetjen e Zbatimit të Strategjisë Ndërsektorale të Drejtësisë në Shqipëri

9. BURIMET FINANCIARE

MD-ja mbështetet në ndihmën e huaj për financimin e Strategjisë dhe synon që, në të ardhmen, të sigurojë buxhet nga fondet shtetërore.